



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

Bordi i Administrimit

Nr. 22 Prot.

Vlorë, më 16 / 04 / 2018

V E N D I M

Nr. 4 , datë 16.04.2018

Bazuar në nenin 47,pikën 1 të nenit 49,germa"n",të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; në nenin 29,pika "a","c", të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit;

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia"Vlorë (në vijim KUPV);

V E N D O S I:

1. Të miratojë tarifat vjetore të studimit për studentët në KUPV, për vitin akademik 2018-2019 ,si më poshtë;
 - a) Për ndjekjen e studimeve në Programin Bachelor dhe DIND,2000 (dymijë)Euro në Vit.
 - b) Për ndjekjen e studimeve në Programin Master Profesional,2000 (dymijë)Euro.
 - c) Për ndjekjen e studimeve në Programin Master Shkencor,2500 (dymijë e peseqind)Euro.
2. Të miratojë nivelet/normat e rimbursimit të studentëve në KUPV,për vitin akademik 2018-2019 si më poshtë:
 - a) Bursë të plotë studimi përfiton studenti që ka përfunduar studimet e arsimit të mesëm me mesatare 10 (dhjetë),si edhe studenti i cili është fëmijë i punonjësit të policisë të rënë në krye të detyrës.
 - b) Gjysmë bursë studimi përfiton studenti që ka përfunduar studimet e arsimit të mesëm me mesatare 9.5 (nëntë pikë pesë),si edhe studenti i cili i përket komunitetit rom/egjiptian.
 - c) Ulje në 25% të tarifës së studimit përfiton studenti që ka përfunduar studimet e arsimit të mesëm me mesatare mbi 9(nëntë).

- d) Studenti i cili në fillim të vitit akademik (nga data 15 tetor deri në datën 15 nëntor) paguan njëherësh tarifën e studimit, përfiton zbritje të tarifës në masën 10% të tarifës vjetore.
 - e) Në fillim të vitit akademik studentit duhet të paguajë tarifën e regjistrimit në masën 200 euro. Kjo shumë është pjesë e tarifës totale të studimit.
3. Ky vendim ti përcillet për zbatim Zyrës së Buxhetit dhe Financës për të mbuluar efektet financiare të kësaj veprimtarie.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

PhD. Siri Hoxha

